

Bahtijar KRYEZIU, Veneranda XHELILI
FJALËT HOMONIMKE DHE POLISEMIKE TE "FJALOR I
FJALËVE DHE SHPREHJEVE TË KOSOVËS" TË QEMAL
MURATIT

Dialektet, nëndialektet dhe të folmet shqipe kanë qenë dhe mbeten prore gurrë e pashtershme e pasurimit dhe e pastrimit të shqipes nga fjalët e shprehjet e gjuhëve të huaja, objektiv i kahershëm i dijetarëve tanë, që nga shkrimtarët e vjetër, rilindësit, e deri te studiuesit e shqipes dhe shkrimtarët e shekullit tonë. Kështu që, pas botimit (te ne) të fjalorëve: "Fjalorth i fjalëve të rralla" (Abdullah Zymberi, 1979); Fjalë e shprehje nga Kosova (Jani Thomai, "Studime filologjike", 1981/2); "Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore" (grup autorësh, 1982); Fjalor dialektor i së folmes së Deçanit (Bajram Mehmetaj, 2011); "Fjalor i Pejës dhe Istogut" (Isa Mulaj, 2011); Fjalë e shprehje popullore nga Lugu i Baranit (Ali R. Berisha); Hani i Elezit leksikor me frazeologji (Fadil Curri, 2013) dhe së fundi "Fjalor popullor" (Abdullah Zymberi, 2014), për hartimin e të cilit lënda ishte eksploruar në disa tërthore shqiptare të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, leksikografisë shqipe, jo moti, këtyre veprave iu bashkua edhe një fjalor mjaft voluminoz e shumë i rëndësishëm "Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës" (IA, Prishtinë, 2018), i pasionantit të madh e gjuhëtarit të shquar, Prof. Qemal Murati, nga e cila vepër jemi përpjekur të veçojmë "Fjalët homonimike dhe polisemike te "Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës", të një areali të caktuar të shqipes, siç është Republika e Kosovës.

"Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës" përfshin një korpus të përfillshëm fjalësh e shprehjesh të Kosovës, të cilat, pos në ndonjë gazetë apo revistë periodike te ne, të paraqitur si material, siç ishte revista "Përparimi", apo revistat që i kemi edhe sot: "Gjurmime albanologjike", "Gjuha shqipe", e ndonjë tjetër, nuk kemi pasur dhe nuk e kemi rastin ta kemi të analizuar, studiuar e sistemuar me kaq zell e sens, siç e ndeshim te Fjalori i autorit Murati.

Një thënie xhevahir e profesor Idriz Ajetit: "Regjistrimi i leksikut ndër dialekte e të folme, vjelja e tij nga literatura e botuar janë një ndër punë të mëdha për t'u kryer", të cilën (moto veprë) e ka shënuar Murati në fillim të punës së tij, e që më duket sikur tek autori, nxënësi i profesor Ajetit, ka qenë një shtysë e mirë, që ky edhe vetë t'i hyjë një pune të tillë, sa të rëndësishme, po aq edhe të vështirë. Përkushtimin që i kishte bërë autori, duke ia kushtuar veprën e vet (profesor Ajetit), me fjalët: "Gjuhëtarit të rrallë dhe Njeriut me vlera Prof. Idriz Ajetit, që punoi me zell e dashuri për fjalën dhe gjuhën shqipe; Prijatarit që në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës të vitit 1968 kërkoi unifikimin e gjuhës letrare shqipe e që bashkoi parcelat e shqipes në një shqipe të vetme; Klasikut mitik të gjuhësisë shqiptare, që e ngriti në mënyrë të epërme albanologjinë shkencore në Kosovë.

Me mirënjohje e përluje para Veprës së tij! Q. M.”, vetëm sa e vërteton edhe më tepër mendimin tonë.

Edhe dy fjalë për autorin e këtij Fjalori.

Disiplinat filologjike të interesimit të studiuesit tonë, Prof. Qemal Murati, janë të shumta. Ai, sikur i etur për të dhënë ndihmesën e tij, sa në një disiplinë, aq edhe në tjetrën, edhe i rreket punës, sa në një të, aq edhe në fushën tjetër. Jo sa për të tërhequr një hulli a për të shënuar një titull më shumë në varganin e shumë punimeve e artikujve të tij, por për të bërë një e më shumë studime, një e më shumë vepra përkritazi me strukturën e gjuhës së sotme shqipe dhe të gjuhëve ballkanike, përkritazi me gjuhësinë e zbatuar dhe gjuhësinë teorike, me dialektologjinë, sociolinguistikën, etimologjinë, onomastikën, si dhe studime të tjera në fushën e letërsisë, të historiografisë e kohët e fundit edhe të leksikografisë sonë. Këtë e dëshmojnë, pa dyshim, veprat e tij të botuara jo më moti se nga fundvitet e 80-ta, të cilat, për shkak të hapësirës, nuk po i zëmë në gojë këtu, e me qëllim që të dalim te tema jonë.

Prof. Qemal Murati, në Preambulën e veprës, tregon metodologjinë e punës së vet për të eksploruar gjithë atë lëndë e për të hartuar këtë vepër aq madhore dhe po aq të rëndësishme për gjuhësinë në përgjithësi e për leksikografinë shqipe në veçanti, duke u shprehur se “si njëri nga ata që janë marrë me fjalën shqipe prej shumë vjetësh, nuk kisha se si të mos interesohesha edhe për fjalën e bukur shqipe të Kosovës, ta qëmtoja atë vis më vis e krahinë më krahinë, duke shkuar edhe vetë në terren apo ta vilja atë dhe nga subjekte dhe nga literatura e botuar, dhe të përgatisja për botim këtë Fjalor të fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës”xi, me “mbi 16 mijë leksemash e shprehjesh frazeologjike” – siç thotë vetë autori i veprës, ku me një fond të mirë fjalësh përfaqësohen homonimet dhe fjalët polisemike të strukura kaherë në trevat shqiptare – si një lëndë e vjelë nga të folmet popullore dhe prurje e rëndësishme edhe për gjuhën letrare. “Leksiku i pasur i të folmeve popullore të Kosovës do të na ndihmojë në zëvendësimin e një mori fjalësh të huaja të përdorura sidomos nga gazetarët tanë, si dhe në plotësimin e zbrazëtirave terminologjike në lëmenj të ndryshëm të jetës e të veprimtarisë sonë”, sidomos kur dihet se “Me lëndën që përmban, Fjalori i shqipes së Kosovës nuk është thjesht vetëm një glosar i fjalëve të rralla dialektore e krahinore, por është dhe një fjalor etnografik, folklorik, historik, etnopsikologjik, sociolinguistik, frazeologjik, onomastik, etimologjik”.

Pas parathënies (Preambulës, siç e quan autori), opinioneve të profesor Gjovalin Shkurtajt, Dr. Ragip Mulakut, studiuesit të shqipes, Viktor Bakillarit, Valter Memishajt, Artur Lamës (?), nuk dimë se çka ka mbetur pa u thënë për Fjalorin e fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës. Megjithatë, nga kjo vepër e studiuesit Murati, këtë radhë, ne kemi veçuar vetëm fjalët homonimike dhe polisemike, të cilat janë eksploruar nga të folmet shqipe të Kosovës, si një lëndë e rëndësishme për t’u trajtuar e studiuar. I morëm në syzim këta dy tipa fjalësh, të cilat më parë, kryesisht, nuk kanë gjetur vend në fjalorët tanë të shqipes, me të cilat dhe fjalë të tjera të ndeshura gjithandej në tërthoret tona, shumë fjalë të huaja, kanë mundur e mund të zëvendësohen me përgjegjëset shqipe. Këtë mundësi na e ka ofruar profesor Murati me botimin e tij “Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës”.

Vepra “Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës” e profesor. Muratit, është njëra nga ato 37 veprat e tij të botuara deri më tani, nga e cila vepër, siç u shprehem pak më sipër, kemi veçuar fjalët homonimike dhe polisemike, të cilat përbëjnë një korpus të mirë fjalësh në këtë fjalor.

Leksemat e zëna në gojë: emra, mbiemra, folje, ndajfolje e më pak pasthirrma, pjesëza e tingullimitime, janë një prurje e rëndësishme për të zënë shtratin e tyre në një fjalës normativ të mbarë shqipes, ngjashëm me ata të gjuhëve të mëdha, jo vetëm të Europës.

Nga mësimet në shkollë dimë se homonimet janë fjalë me të njëjtën përbërje tingullore dhe me përmbajtje kuptimore krejt të ndryshme. Si të tilla, homonimet kanë lindur për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në gjuhë gjatë zhvillimit të saj historik. Pra, fjalë dikur të ndryshme, me kohë janë përputhur nga tingëllimi, por nga kuptimi kanë mbetur përsëri të ndryshmexi, si p.sh. (BÁT, -I m. Vegël për të zënë minj, thëllëza etj. të cilët e mashtrojnë duke vënë në bat bukë ose ushqim tjetër që i joshin të hyjnë në të. I thonë edhe kurtht (Hani i Elezit). Grackë, kurth (Korishë, Prizren).

BAT, -I ndajf. Lojë e vjetër meshkujsh që luhej në stinën e dimrit, dikur ishte shumë e përhapur. Bat-i është shamia e lidhur nyje që përdorej në lojën bat (Deçan). Lojë për të rinjtë ose burrat, badifallak. Thuhet edhe bat-bat (Lugu i Baranit);

TÉSHA (e) fol. E takova, e zateta (Vushtrri).

TÉSHA, -T f. sh. 1. Cipë e bardhë që vihet mbi kokërr të syrit (Junik); sëmundje sysh e shkaktuar nga tymi (Kaçanoll, Shala e Bajgorës). 2. Gjakrat e muajit të grave (Cerajë, Shala e Bajgorës)).

Ngjashëm me homonimet, por jo plotësisht të njëjta, janë edhe fjalët polisemike, fjalë të cilat kanë më shumë kuptime (kokë – pjesë trupi dhe kokë – njeri i mençur: ai është kokë)xi dhe, si të tilla, nuk dallojnë shumë nga fjalët përgjegjëse, si p.sh.:

PËRDERECÁK m. 1. Endacak, njeri që kalon kohën me vizita të panevojshme nëpër miq e shokë (Llap). 2. Qen endacak (Jabllanicë, Medvegjë).). Përdecak. Vjen përditë si përdecak (Brainë, Llap);

KÉRR, -I m. 1. Qerre me kafshë tërheqëse. Kerri i drunit, kerri i kive; kerri kuale – kerri i hekrit. fraz. Mos u  n me kerr tha:t neper oborr - mos fol gjepura në o:d t’burrave. 2. Automobil, limuzinë, veturë, etj.

Në fjalorët e ndryshëm të shqipes (kryesisht në atë të vitit 1981), kemi gjetur rreth 700 e sa çifte, vetëm homonime, të tipave të ndryshëm, që përfaqësojnë gati 1470 fjalëxi, e dhënë kjo që dëshmon se homonimet janë një klasë më vete leksikore, të cilat i bashkon, jo vetëm forma tingullore e njëjtë, por edhe lidhja kuptimore e mirëfilltë. Sakaq, me këmbëngulësinë, elanin dhe durimin e pashoq që tregoi në punën e tij Prof. Qemal Murati, këta dy tipa fjalësh, na dalin goxha me denduri edhe më të madhe në gjuhën tonë.

Se është kështu, nga fjalët e tilla që i kemi veçuar këtu, del se në këtë Fjalor kemi mbi 2300 çifte homonimesh e fjalë polisemike, që përfaqësojnë gati fjalë.

Numri aq i madh i fjalëve homonimike dhe polisemike në këtë Fjalor (popullor), që flinin të qeta ndër shekuj në arealet e shqipërisë, tani të trazura nga pena e Prof. Qemal Muratit, do të jenë të mirëseardhura për pasurimin e fjalësit të shkollarëve, mësuesve, gazetarëve, shkrimtarëve, gjuhëtarëve e dashamirëve të tjerë të gjuhës shqipe, ngase një mori fjalësh të huaja të përdorura edhe tani nga këto shtresa intelektualësh dhe të tjerë, mbështetur në këto fjalë, do të mund të zëvendësojnë shumë fjalë të huaja të panevojshme për shqipen. Këtë bindje tonën e mbështesim edhe në thënien e studiuesit e leksikografit të shquar, Miço Samara, i cili kishte pohuar se “Trualli ynë amtar fsheh një thesar të tërë fjalësh të bukura shqipe, të cilat mund të zëvendësojnë lehtësisht disa nga fjalët e huaja, që përdoren pa nevojë e disa herë edhe nga mania për t’u dukur ose për të folur me “fjalë të mëdha” të pakuptueshme për një masë të gjerë të popullit”.

Këta dy tipa fjalësh i ndeshim të paraqitur në të gjitha fushat e jetës, si: emërtime dhe frazeologjizma që lidhen me veshjen... me doke e ceremoni të ndryshme (etnografizma), me terminologjinë për pajisjet, mjetet dhe veglat bujqësore, të zejeve, si ato të tabakëve - lëkurëpunuesve, të qeleshepunuesve, të çibukpunuesve etj.; emërtime popullore të bimëve (etnobotanizma), emërtime popullore të shpendëve, sidomos të zogjve, po edhe të gjallesave e kandrrave (etnozoologjizma); emra dhe mbiemra që tregojnë ngjyrat, pastaj emërtime të njerëzve sipas dukës a sipas vetive morale etj.xi

Sigurisht se krahas një fondi aq të pasur dhe të mëvetësishëm fjalësh, njësisht leksikore e frazeologjizma, sintagma e shprehje të ngurtësuara fjalësh, të vjela e të kokërruara nga Murati me aq përkushtim e dije, në Fjalorin e tij ndeshim, natyrisht, edhe një korpus të mirë fjalësh homonimike dhe polisemike, të shumtën të shqipërisë, por edhe elemente të huazuara leksikore nga serbishtja, turqishtja etj. Sa për ilustrim po përmendim këtu disa nga homonimet:

ÁM/Ë, -A f. Mbretëresha e bletëve (Petreshticë). Âm dhe matk (Shala e Bajgorës).

ÁM/Ë, -A f. Pendë për ta kthyer ujin në mulli (Podgur). Në Shalë i thonë tânt.

ÇUK, -I m. sh. -A, -AT. Kulmi, maja e qefit. E kemi ba çukin e qefit; me hangër e me pi çka na ka dashtë shpirti! (Lugu i Baranit).

ÇUK, -I. m. sh. AT. Gropë e vogël. Ma kan ba livadhin krejt çuka, nuk vyn ma (Reka e Gjakovës).

DUC pasth. Të ndeshurit me dikë a me diçka (Bukosh, Suharekë.).

DUC, -I mb. Mashkull me shputa të këmbëve të deformuara (Opojë).

KIPC pasth. Ndjellja e lopës (Has, Prizren).

KIPC, -I m. Gur kripe për ta lëpirë dhitë (.Planejë, Hasi i Prizrenit))

RRÓK ndajf. Nyjë, toph; zakonisht thuhet për tjerë që derdhet fort e bëhet nyjë. Mos e dredh fort leshin se bahet rrok – nyjë në formë tophi (Morava e Epërme).

RRÓK ndajf. 1. Pa zier, pa pjekur. fig. ende i papjekur, me gjeste të fëmijëve (Deçan). 2. Perime e papjekur. Po e ha një spec rrok – ashtu siç është dhe pa e shoqëruar me asgjë. Po pi raki rrok – thatë, pa meze (Rrafshi i Dukagjinit). Po i hajke spëcat rrók! (Istog),

SHKÁ përem. 1. Përemër pyetës çka, çfarë. Shka dashti ai? 2. Përemër lidhor, që, i cili. Un e thash atë shka dita (Reka e Gjakovës). Shka ka culla çu kan? (Hani i Elezit). Shka t'ham (Drrnicë).

SHKÁ, -VI m. Pjesëtar i etnosit sllave (serb, malazez); top. Ara Shkavit (Hani i Elezit) etj., dhe fjalët polisemike:

BAC, -i m. 1. babë, 2. vëllai i madh; BÁLÇ, -I m. Ushkur për të lidhur fëmijën, foshnjën për djepi për të mos u përmbysur e rrëzuar (Rugovë, Shkrel, Dunav (Karadak i Gjilanit)). Lulak-i (Morava e Epërme). 2. Ushkuri i teshave që shërben si rrip (Zhabar, Mitrovicë).

CÁKULL, -I m. sh. -A. 1. Trastë barinjsh, 2. Trastë librash (Rugovë).

GRÓSH - emër burri, GRÓSH/E - emër femre (Kaliçan, Istog).

PËRKREH fol. 1. Kreh dikë për së tepërmi, shumë. Po shumë e kishe pas përkreh djalë, bre! 2. Kreh shumë një mullar bari (Drenicë).

GÚRR/Ë, -A 1. Rrjedhja e furishme e ujit nga një burim i caktuar. 2. Rrjedhja e pandërprerë e gjakut nga një plagë. E kish pre: dorën e i shkojke xhaku gu:rr krejt! (Istog).

Kemi theksuar se disa homonime e polisemi të këtij Fjalori, pos të etimologjisë shqipe (pjesa dërmuese) – disa madje shumë të vjetra shqipe, si:

BARDHÉC, -I m. 1. Njeri me flokë dhe çehre të bardhë. 2. Emër personal mashkulli (Dushkajë, Gjakovë). 3. euf. Morri (Zym, Has – Prizren)). 4. euf. Gjarpri. E ka nxanë bardheci xhanë (Zym, Has – Prizren)).

BARDHÉC/Ë, -A f. Dhi e bardhë (Shala e Bajgorës). 2. Cjap ose edh i bardhë (Shala e Bajgorës) etj., këtu ndeshim edhe aso me etimologji:

- sllave:

BÂS, -I (serb.) m. 1. Topth bore. Mos u rrehni me basa t'borë, bre bab! (Pejë). 2. Plis dheu (Shalë e Bajgorës). Bucë, copë dheu, toph dheu, toph bore (Pejë, Istog).

DRÁNG, -I m. (sll.) Dru u gjatë që e përdornin femrat kur shkonin për të larë petka në lumë. 2. Shuli i derës (Gjilan, Petreshticë. Një tufë drurësh më të hollë, deng (Mramor, Gollak)). Drangi ujit shkop me të cilin kanë mbartur ujë (Dushkajë e Gjakovës).

KLÉÇK/Ë, -A f. (serb. klečka) 1. Ndërskëmbëse, truk, mashtrim sportiv. Pelivan ja çiti kleçkën e e rrzoj n' kokërr t' shpinës (Hani i Elezit). 2. Pengojcë, shkop i dredhur që u vihet në këmbë kafshëve dëmtore. Ja ka çit kleçkën (Vërban, Morava e Epërme)).

VÍDËR, -A f. (serb. vidra) Shtazë laramane e hijshme që jeton në ujë e në tokë; epitete për diçka të bukur. Mori vider, moj vidru:sh - femër shumë e bukur; emër lope qimekuqe me brirë të kthyer përpara (Deçan). 2. Lopë me vija të zeza nën bark ose edhe shpinës (Rugovë). Emër i lopës së kuqe (Deçan)...

- turke: AÇÍK ndajf. (turq. açık) Ndaras, veç. Açik jemi tash (Llap).

AÇIK-AÇIK ndajf. (turq. açık) Veçmas, ndaras. Naçallniku i Serbis i shtike n' zyre t'vet açık açık e i e i vetke se kush ka arme (Istog).

ALLÇÁK, -I mb. (turq.) I zoti, i shkathët, orator. 2. i poshtër, horr, i pacipë, arrogant. He allçak, as mos um nguc, as s'po t'nguci (Pet.). 3. Njeri mendjemadh, torollak, i pakuptueshëm, papajtueshëm. Aj ish allçak i madh (Hani i Elezit).

BAJRAKTÁR, -I m. (turq. bayraktár) 1. Udhëheqës e prijës i institucionit të bajrakut; ai që merr dhe e mban flamurin në vijën e parë të frontit kundër armikut; flamurtar (Deçan). 2. Kositësi i parë, prijësi i kosarëve (Romajë, Has)). 3. Ai që mban flamurin në dasmë. Edhe si mbiemër familjar Bajraktari. Bajraktari i Ostrozubit.

ÇAKÁLL, -I f. (turq. çakal) zool. 1. Bishë e egër. 2. mb. Njeri që flet shumë, fjalaman. Aj ishte çakall ka goja (Hani i Elezit). 3. I zhdërvjellët (Suharekë).

KÁT, -I m. (turq. kat) 1. Palë rrobash, teshash. 2. Shtresë nëntoke, mbitoke, shtëpie (Hani i Elezit).

VIRÁN ndajf. (turq.) Në gjendje shumë të vështirë ekonomike. Punt i kishin viran ata t'dajve (Hani i Elezit);

VIRÁN, -I mb. (turq. viran) Mjeran, i mjerë, njeri në gjendje të keqe (Hani i Elezit). 2. Fig. Njeri i zoti. Ma viran nuk ka! E meçme asht viranja! etj.;

- vllahe: GALË - 1. lopë apo dele me qime të zeza. 2. fig. grua e papastër. Hiçju asaj gale, GALAN-I - 1. dash krejtësisht i zi 2. Mashkull tepër zeshkan. 3. Njeri me shtat të madh (Gjilan), etj.

Mbi 2300 çifte fjalësh të tilla (ose 14,37 %), me afro 3550 fjalë me kuptime të caktuara, që arrijnë një përqindje prej 22,18%, nga një korpus i përgjithshëm i lëndës me mbi 16 mijë zëra, të

përmbledhur në Fjalor, janë shënuar sipas shqiptimit në të folmet përkatëse, me shenjat diakritike që i njeh dialektologjia e shqipes dhe janë radhitur sipas alfabetit të gjuhës shqipe, pjesën dërrmuese nga të cilat e përbëjnë, siç kemi theksuar edhe më sipër: emrat, mbiemrat, foljet, ndajfoljet, pjesëzat dhe pasthirrat, pa përjashtuar edhe ndonjë tingëllimë e tip tjetër të rrallë. Fjalët në këtë Fjalor, për nga struktura e tyre fjalëformuese, janë kryesisht fjalë të parme, të prejardhura dhe kompozita.

Sipas rendit alfabetik, kemi këtë numër fjalësh (homonime e fjalë polisemike): A = 33 çifte (48 leksema semantike), B = 213 (373), C = 58 (95), Ç = 108 (169), D = 81 (127), Dh = 7 (11), E = 6 (12), Ë = 0, F = 100 (151), G = 118 (184), Gj = 15 (21), H = 63 (116), I = 10 (16), J = 15 (21), K = 354 (507), L = 108 (151), Ll = 45 (65), M = 123 (197), N = 54 (71), Nj = 0, O = 12 (19), P = 169 (253), Q = 2 (2), R = 18 (27), Rr = 68 (105), S = 77 (124), Sh = 125 (207), T = 94 (148), TH = 32 (47), U = 27 (38), V = 69 (90), X = 8 (11), Xh = 26 (41), Y = 4 (4), Z = 22 (31), Zh = 37 (62).

Nga të dhënat e paraqitura të fjalëve homonimike dhe polisemike del se me më së paku denduri (frekuentim) kanë qenë ato të cilat fillojnë me nistoret: Q = 2 (2), Y = 4 (4), E = 6 (12), kurse me denduri më të madhe paraqiten fjalët që fillojnë me shkronjat: K = 354 (507), B = 213 (373), P = 169 (253) e kështu me radhë. Ndërkaq te shkronjat: Ë, Nj, nuk kemi ndeshur asnjë fjalë homonimike a polisemike.

Fjalët në këtë fjalor, pra edhe homonimet e polisemitë, janë paraqitur me 3 lloje shkronjash. Me shkronja të mëdha, të zeza (bold), me të cilat janë shtypur shkronjat nistore të fjalëve përkatëse. Me të pjerrëta (italic) të panxira, janë shënuar akronimet për gjininë e emrit dhe për të treguar se ç'pjesë ligjërata janë ato fjalë, si dhe fjalët origjinale të shënuara si shembuj nga subjekte të caktuara, ndërkaq me shkronja normale janë dhënë shpjegimet - domethënia e fjalës. Numri arab është vënë para fjalëve, kur fjala ka pasur më shumë se një kuptim, duke treguar se sa herë është përsëritur fjala e tillë, si fjalë homonimike dhe polisemike. Në fund të çdo fjale të vjelë është shënuar burimi i tyre (me akronim), përkatësisht vendi ku është gjetur fjala. Është për të theksuar se autori, në këtë fjalor, me theksin e pjerrtë të kthyer në të djathtë (') mbi shkronjat e fjalëve nistore ka dalluar zanoret e gjata, kurse zanoret hundore të këtyre fjalëve i ka dalluar me theksin hundor (^) e për zanoret e hapura të fjalëve ka përdorur edhe këtë shenjë diakritike (ˇ), siç praktikohet zakonisht edhe te fjalorët e tjerë dialektologjikë të gjuhës shqipe. Te fjalët origjinale të subjekteve të caktuara, për zanoret e gjata ka përdorur edhe dy pikat (:), si p.sh.: E kish pre: dorën e i shkojke xhaku gu:rr krejt! (Istog).

Po e përmbylim këtë shkrim të shkurtër me fjalët e vet autorit të veprës, i cili, duke shkruar për rëndësinë e kësaj vepre, konstaton me të drejtë se "Fjalori ka vlera të paçmuara gjuhësore dhe pasuron kolanën e botimeve leksikografike të glosarëve dialektorë të shqipes; ky botim është një pasuri e mëtejme, dhe do të ishte mirë të pasohet në të ardhmen e afërt dhe nga një fjalor tjetër i onomastikës së këtij vendi - toponimisë dhe patronimisë së Kosovës, i cili do të na jepte një pamje edhe më të plotë të visareve etnolinguistike të kësaj tërthoreje, me interes të posaçëm për studimet albanologjike". Nga këta rreshta ne kuptojmë se ky albanolog, zelltar i madh e tepër

prodhimtar, shumë shpejt do të na gëzojë edhe me një sihariq tjetër, me botimin e një fjalori onomastik – toponimik e patronimik të Kosovës, duke ia bashkuar kështu edhe një vepër tjetër varganit të botimeve leksikografike të shqipes. Me këtë rast neve nuk na mbetet gjë tjetër, pos ta falënderojmë autorin dhe njëherë për veprën e sapo botuar, me shpresë se nga profesor Murati frik do ta kemi në duar edhe fjalorin e radhës të onomastikës – toponimisë dhe patronimisë së Kosovës.